



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**VENDIM**

**NR. 2, DATË 07 / 05 / 2024**

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIM TË STATUSIT  
“INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR” PËR  
PROJEKTIN E INVESTIMIT “KAMPINGU PA EMËR – GURI I LËMUAR” ME  
SUBJEKT APLIKUES “KAMPING PA EMËR PEPOSHI KARPEN-KAVAJË”  
SH.P.K. ME NUIS K72701801L**

Në mbështetje të 8, 9, 13 dhe 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/c të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti “Kampingu pa emër – Guri Lëmuar” konsiston në ndërtimin e një agroturizmi, kamping me vila druri dhe vende për kampera e tenda, serë, shërbim tregu fruta -perime nga produkte të zonës në ZK 2099, në Guri Lëmuar, Spille, Bashkia Kavajë.
- Projekti synon të realizohet nga subjekti “Kamping pa emër Peposhi Karpen - Kavajë” sh.p.k. me NUIS K72701801L.

- Vlera e investimit për këtë projekt parashikohet të jetë 5,223,868 (pesë milion e dyqind e njëzet e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) Euro dhe numri i të punësuarve parashikohet të jetë 81 (tetëdhjetë e një) persona.
- Pasuritë Nr: 90/29, 90/38 dhe 90/28 në ZK nr. 2099, Bashkia Kavajë, janë në pronësi të subjektit aplikues. Subjekti kërkon masë mbështetëse përdorim të pasurive të paluajtshme të pretenduara shtetërore, afërisht një gjurme prej rreth 30 ha, pjesë të pasurisë nr. 106/22.
- Zona përkatëse e plazhit sipas koordinatave në dokumentin e sjellë nga aplikuesi, nuk rezulton të jetë përfshirë në listën e plazheve, referuar VKM-së nr. 171, datë 27.03.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar.
- Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

## **KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

### **VENDOSI:**

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Kampingu pa emër – Guri Lëmuar”, me subjekt investues “Kamping pa emër Peposhi Karpen - Kavajë” sh.p.k. me NUIS K72701801L, Guri Lëmuar, Spille, Bashkia Kavajë në procedurën e asistuar dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Sipërfaqja ku synohet të shtrihet projekti është e llojit “pyll” dhe këto pasuri duhet t’i nënshtrohen procedurës së heqjes nga “fondi pyjor” dhe/ose ndryshimit të kategorisë së përdorimit. Miratimi i këtij projekti kërkon ndryshime përkatëse të parametrave të zhvillimit të zonës si rishikim të Planit të Përgjithshëm Vendor Kavajë ose hartim Planit të Detajuar për Zonat me Rëndësi Kombëtare (PDZRK).
3. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare

e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTËR**

EDI RAMA

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

BELINDA BALLUKU

**MINISTËR I EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT**

BLENDI GONXHJA

**MINISTËR I FINANCAVE**

ERVIN METE

**MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT**

MIRELA KUMBARO

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

ANILA DENAJ

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**  
**ODISE MOÇKA**

**SEKRETARIATI TEKNIK I KIS**  
**LAURA PLAKU (SARO)**